

STATUT I SHOQERISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“ CBLs-Crafting Better Life Solutions “ sh.p.k

Në këtë statut

- “Ligji” është Ligji Nr. 9901 dt.14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqërite tregtare”
- “Statuti” është Statuti I shoqërisë

KREU I

Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia

Neni 1

Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

- (1) Sot më datën 18.06.2018, une themeluesi, kam krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin CBLs-Crafting Better Life Solutions SH.P.K
- (2) Themelues I shoqërisë është

Arsi Ibro , shtetas shqiptar, i datëlindjes 11.06.1996, I biri I Ndrichimit, lindur në Tiranë

Emërtimi “CBLs-Crafting Better Life Solutions”sh.p.k dhe emri i administratorit do të figurojnë në të gjitha aktet ose dokumentet e nxjerra nga shoqëria dhe që u drejtohen të tretëve

Neni 2

Objekti

Objekti I aktivitetit të kësaj shoqërie është

- Shërbim I Telemjekesisë, shërbim shëndetësor në distancë, I mundësuar nëpërmjet Teknologjisë së Telemedicinës, që aplikon Sisteme me komponente hardware dhe software të lidhur së bashku, për të krijuar një shtrat të sigurt transferimi për informacionin shëndetësor nëpërmjet teknologjisë së avancuar të Telekomunikacionit
- Ndërtimin e qendrave shëndetësore
- Import-eksport paisjesh mjekësore apo ndihmëse mjekësore, paisjesh elektronike në përgjithësi, paisje zytrash, ...etj

Neni 3

Kohëzgjatja

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore të papërcaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit

Neni 4

Selia

Shoqëria do ta ketë selinë qendrore në adresën Vlorë, Himarë, Lagjja Protopapë, ndërtesë te Zona Kadestrale 3095, Nr. Pasurie 105/145

Shoqëria mund të hapë edhe zyra perfaqësie, degë, të krijojë filiale, dhe/ose të realizojë çdo lloj pjesëmarrje të parashikuar nga ligji në shoqëri të tjera, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë

KREU II

Kapitali

Neni 5

Kapitali Themeltar

(1) Kapitali fillestar I shoqërisë është 100 lekë

Ortaku i vetëm i shoqërisë është zotërues i 100% të kapitalit të shoqërisë

Neni 6

Zmadhimi dhe zvogëlimi I kapitalit

Kapitali I shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit nga gjykata kompetente e një eksperti të autorizuar për këto kontribute, sipas kërkesës së administratorit

Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë

Zvogëlimi I kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit

Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë

Neni 7

Transferimi I kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre, mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a. Kontributit në kapitalin e shoqërisë
- b. Shitblerjes
- c. Trashëgimisë
- d. Dhurimit
- e. Çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe në statut

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie

KREU III

ORGANET VENDIMMARRËSE DHE DREJTUESE

Neni 8

Organi vendimmarrës

Asambleja e ortakëve është organi I vetëm vendimmarrës I shoqërisë

Asambleja e ortakëve është organi I vetëm vendimmarrës I shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj

Asambleja e përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a. Përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë
- b. Ndryshimin e statutit
- c. Emërimin dhe shkarkimin e administratorëve
- d. Emërimin dhe shkarkimin e likujduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar
- e. Përcaktimin e shpërblimeve për personave të përmendur nëshkronjat c dhe d te kësaj pike
- f. Mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë
- g. Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë
- h. Zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit
- i. Pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre
- j. Perfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve
- k. Riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë
- l. Miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë
- m. Çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi, nga një ortak tjetër, apo nga një person I tretë

Administratori I shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues I ortakëve në asamblenë e përgjithshme

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin dhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite

Neni 9

Mënyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës dhe t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë

Kur Asambleja e Përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë

Neni 10

Kuorumi

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme, vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30% të kuotave

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorunit të përmendur më lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite

Neni 11

Marrja e vendimeve

Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të zotëruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës për çështje të tjera si:

- a. Përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë
- b. Emërimin dhe shkarkimin e administratorëve
- c. Emërimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të miratuar
- d. Përcaktimin e shpërblimeve
- e. Mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë
- f. Përfaqësimin e shoqërisë në Gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve
- g. Miratimin e rregullave proceduriale të mbledhjeve të asamblesë

Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKR për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë

Neni 12

Përgjithshme nga e drejta e votës

1. Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:
 - a) Vlerësimin e veprimtarisë së tij
 - b) Shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij
 - c) Ngritjen e ndonjë padie ndaj tij nga shoqëria
 - d) Dhënieve ose jo të përfitimeve të reja
2. Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku të cilin ai përfaqëson

Neni 13

Administrimi

- (1) Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit
- (2) Administratorët e një shoqërie mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administrator të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm
- (3) Personi i mëposhtëm caktohet si administrator i parë i shoqërisë

Arsi Ibro, shtetas shqiptar, i datëlindjes 11.06.1996, i biri i Ndrizimit, lindur në Tiranë

Neni 14

Kompetencat e Administratorëve

Administratorët kanë të drejtë dhe detyrohen të:

- a) Kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare të vendosura nga asambleja e përgjithshme
- b) Përfaqësojnë shoqërinë tregtare
- c) Kujdesen për mbajtjen e saktë dhe të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë
- d) Përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim
- e) Krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë
- f) Kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit"

g) Raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare

h) Kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut

Administratorët janë të detyruar të thërrasin Asamblenë e Përgjithshme në rastet kur

- sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojnë ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim
- shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktivet, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5% të asetëve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara
- shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara

Nëse Asambleja e Përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkarisht shoqërinë

Asambleja e Përgjithshme mund të shkarkojë në çdo kohë administratorët, me shumicë të zakonshme. Paditë që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi

Neni 15

Përgjegjësitë e Administratorit

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë, ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17, e 18 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" administratori detyrohet:

1. a) Të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim dhe në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis
- b) Të ushtrojë kompetencat që i njihen me ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita
- c) Të vlerësojë me përgjegjësi çështjet për të cilat merret vendim
- ç) Të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ato të shoqërisë
- d) Të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm

2. Administratori gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim

3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standartet profesionale, sipas pikave 1 dhe 2 të këtij neni, është i detyruar të dëmshpërblejë ndaj shoqërisë dëmet që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ai apo personat e lidhur me të kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave në mënyrë të rregullt e sipas standarteve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", kryen veprimet e mëposhtme:

- a) U kthen ortakëve kontributet
- b) U paguan ortakëve interesa apo dividendë
- c) U shpërndan aktivet shoqërisë
- d) Lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet
- e) Jep kredi

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose së bashku, kanë të drejtën të ngrenë padi penale ndaj administratorit Padiëstit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë dhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës

KREU IV

Viti financiar-ekspertët

Neni 16

Viti financiar

Viti financiar I shoqërisë fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor. Përjashtimisht viti I parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe mbyllet më 31 Dhjetor

Neni 17

Ekspertët

Eksperti ka për detyrë të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko-trgtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakëve

Në përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për njerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor, si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar t'ja paraqesë e dorrëzojë në kohë ortakëve për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e të drejtës vendimore që ka

KREU V

Prishja- Riorganizimi I shoqërisë

Neni 18

Prishja dhe likuidimi

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë:

- a) Kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj
- b) Me vendim të asamblesë së ortakëve
- c) Me hapjen e procedurave të falimentimit
- d) Nëse nuk ka kryer veprime tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi I veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit"
- e) Me vendim të Gjykatës

Në këtë rast ortakët marrin vendim me shkrim në të cilën parashikojnë menyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar një apo disa likuidatorë dhe shënuar në çdo document të njerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë "Shoqëri në Likuidim e sipër"

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga ortakët

Nëse ortakët nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person I interesuar mund t'i drejtohet gjykatës për të caktuar një likuidues

Neni 19

Riorganizimi I shoqërisë bashkim-ndarja

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore, të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”

Neni 20

Baza Ligjore

Shoqëria do zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar

Për sa nuk parashikohet në këtë statut do të zbatohen dispozitat e ligjit “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë

Neni 21

Mosmarrëveshjet

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare

ORTAKU
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
CBLS-CRAFTING BETTER LIFE SOLUTIONS

Arsi Ibro

